



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E FLETËS TIP SIPAS KËRKESËS SË KOMITETIT PËRFAQËSUES, PËR
NISMËN LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR
PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR TË
AUTORËVE TË KRIMEVE SEKSUALE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.06.2020, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, pika 4, neni 10 pika 1, 2 dhe 3 e ligjit nr.54/2019 "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve;

V Ë R E N

Në datë 09.06.2020, Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse znj. Iris Luarasi përfaqësuese e Qendrës "Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, znj. Ines Leskaj përfaqësuese e shoqatës "Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri" dhe znj. Mirela Arqimandriti përfaqësuese e Qendrës "Aleanca Gjimore për Zhvillim kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,



Nr. 13 i vendimit Data 30.06.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale".

kërkesat nr.1149 prot., datë 09.06.2020 dhe nr.1149 prot., datë 18.06.2020 për pajisje me fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve për propozimin e projektligjit "Për krijimin e Regjistrisë Kombëtare të Autorëve të Krimeve Seksuale". Bashkëlidhur kërkesës komiteti përfaqësues ka depozituar edhe kopje të kartave të identitetit.

Projektligji që do të propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës së Komitetit përfaqësues, ka për qëllim mbrojtjen e viktimave nga abuzimi seksual nëpërmjet miratimit të projektligjit "Për krijimin e Regjistrisë Kombëtare të Autorëve të Krimeve Seksuale"

Për realizimin e kësaj nisme ligjore është krijuar Komiteti Përfaqësues i nismës ku secila organizatë ka caktuar një përfaqësues, përkatësisht Qendra "Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza" ka caktuar si përfaqësuese Drejtoren, znj. Iris Luarasi, Shoqata Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" ka caktuar si përfaqësuese Drejtoren znj. Ines Leskaj, dhe Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim ka caktuar si Përfaqësues znj. Mirela Arqimandriti.

Ky komitet, përfaqësues i nismës do të merret me gjithë procesin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve.

Kërkesën e tyre përfaqësuesit e nismës ligjvënëse e bëjnë në mbështetje të nenit 6, pika 4, neni 10 pika 1 e ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë".

Në mbështetje të nenit 10 pika 2 të ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë", KQZ, duhet të pajis përfaqësuesit e nismës me fletën-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme. Referuar nenit 10 të ligjit të sipërcituar, fleta-tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në njërin duhet të përmbajë informacionin mbi nismën ligjvënëse që do të propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për përfaqësinë / komitetin përfaqësues të nismës ndërsa në anën tjetër duhet të përmbajë; numrin rendor, gjenealogjetet e zgjedhësve që mbështet nismën, vendin e datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësve, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Referuar nenit 13 pika 1 e ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë", KQZ, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës për pajisjen me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve, përcakton me vendim, sipas propozimit të përfaqësisë/komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe nënshkrimeve elektronike. Referuar kërkesës, periudha për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të kësaj nisme ligjvënëse, do të jetë 4 (katër) muaj nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.



Nr. 13 i vendimit Data 30.06.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për krijimin e Regjistrisë Kombëtare të Autorëve të Krimeve Seksuale".

Kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përmban, informacionin mbi nismën ligjvënëse që do ti propozohet Kuvendit, qëllimin dhe shpjegimin në mënyrë të përmbledhur të saj si dhe të dhënat e komitetit përfaqësues të nismës.

PËR KËTË ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 6, pika 4, neni 10 pika 1, 2 dhe 3 e ligjit nr.54/2019 "Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të bëhet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Publikimin e fletës tip në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 13 i vendimit Data 30.06.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për miratimin e fletës tip sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale".